



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:035336
Datë: 30.07.2024
Numri i dokumentit: 05997668

PA1.nr.940/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Avdullah Ahmeti, kryetar i kolegjit, Mehmet Ndrecaj, dhe Ferit Osmani anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.J nga fshati, Komuna e Skenderaj, për shkak të veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.13/2024, datë: 26.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **23.07.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.13/2024, datë: 26.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatë Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.13/2024, datë: 26.04.2024, të akuzuarin A.J, e ka shpallur fajtor për veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar **dënim me burgim të kushtëzuar** në kohëzgjatje gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, me kusht që i pandehuri brenda periudhës kohore prej (1) një viti, /periudha e verifikimit/, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale të natyrës të njëjtë, apo më të rëndë.

I pandehuri A.J lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës, për shkak të kushteve të rënda ekonomiko-sociale pasi që do të rrezikonte gjendjen e tij materiale si dhe të personave që është i detyruar t'i mbështesë materialisht, e po ashtu i njëjti është përfitues i asistencës sociale. Pala e dëmtuar A.J ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke i propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar, dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të rëndë.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.941/2024, të dt. 19.06.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar sa i përket vendimit për sanksion penal të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të lart me burgim.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPPRK-së, konstatoj se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, sipas detyrës zyrtare, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këtë drejtim, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore nga neni 369 i KPPRK-së, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë përshkruar qartë të gjitha veprimet inkriminuese të të akuzuarit, në të cilat veprime manifestohen të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i akuzuari. Po ashtu dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare me rastin e vendosjes në këtë çështje penale.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mund të kontestohet, për faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, dhe gjyqtari i vetëm gjykues e ka aprovuar një pohim të tillë, dhe bazuar në nenin 383 par.2 të KPPRK-së, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoj vetëm në bazë të pretendimeve në ankesë të parashtruara nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë.

Po ashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur as për shkak të shkelje të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare për shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as me shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, në radhë të parë për faktin se nga pranimit i fajësisë nga i akuzuari dhe aprovimi i këtyre deklaratave nga Gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, dhe me këtë rezulton se është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë manifestuar elementet qenësore të kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar i akuzuari, si dhe për faktin se kjo vepër për të cilën është gjykuar i akuzuari është vepër penale, nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe ndjekjen penale për këto vepra penale, dhe as zbatim të gabuar të Kodit Penal.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar dhe konstatuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, morri parasysh këto rrethana pranimit e fajësisë në tërësi për veprën penale për të cilën akuzohet, gjë që ka ndikuar që së bashku me rrethanat tjera, po ashtu gjykata lidhur me kushtëzimin e dëmit ka vlerësuar edhe kërkesën e palës së dëmtuar A.J, që gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ti marrë për bazë dhe ka kushtëzuar dënimin e shqiptuar që i njëjti të mos ekzekutohet, kurse si rrethana rënduese gjykata ka marrë për bazë faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, ndaj të dëmtuarës-bashkëshortes se tij, ashtu që nga veprimet e të pandehurit, të dëmtuarës i është cenuar dinjteti dhe personaliteti i saj, pastaj shkallën e përgjegjësisë penale, i njëjti edhe më herët ka qenë i dënuar për vepra të tjera penale.

Gjykata e Apelit këtë konstatim të Gjykatës së shkallës së parë e vlerëson si të drejtë dhe në proporcion me dënimin e shqiptuar nga e njëjta. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit më të rëndë për të akuzuarin. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate, edhe bazuar në rrethanat relevante ekzistuese në rastin konkret, dënim i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit.

Kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, e i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.940/2024, me datë 23.07.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Ilmije Rexhepi Beqiri

Kryetari i kolegjit

Avdullah Ahmeti

Antarët e kolegjit:

Mehmet Ndrecaj

Ferit Osmani